



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 64 par.2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT – RREGULLOREN PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSOR PËR FËMIJËT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve:

Projekt – Rregullorja për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët .

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt Rregullore mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt – Rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët më së largu me date 10.04.2018.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

1Nr. 560-17886
Lipjan, më 23.03.2018

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti